



Drejtuar: Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion

Lënda: Dhënie mendimi gjatë Konsultimit Publik të Draft Strategjisë Ndër Sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2023

Nga: Organizata Instituti Shqiptar i Shkencave AIS, promotor i OpenDataAlbania

Data: 30 Gusht 2024

E nderuar zonja Ministre,

Të nderuar zyrtarë të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion.

Përmes kësaj shkrese më lejoni t'ju përcjell konsideratë për punën e realizuar nga Institucioni juaj për hartimin e Draft Strategjisë Ndër sektoriale kundër Korrupsionit. Gjithashtu dëshiroj t'ju falënderoj për gjithë procesin për konsultim dhe marrje mendimi të realizuar me aktorë të shoqërisë civile dhe biznesit. Duke e vlerësuar dokumentin, qëllimet, objektivat dhe masat prioritare të parashikuara, Organizata Instituti Shqiptar i Shkencave (akronim AIS), i njohur si Promotor i OpenData për Shqipërinë dëshiron të parashtojë edhe dy propozime për përfshirje në Strategji si vijon:

1. Të Shtohet tek Objektiv Specifik 1.3 edhe Parandalimi i Korrupsionit, Depolitizimi dhe Përmirësimi i Integritetit i Ndërmarrjeve me Zotërim Publik

Sugjerohet që Pjesë e Strategjisë përveç Sektorëve të cituara në draft, të konsiderohet edhe sektori i Shoqërive dhe Ndërmarrjeve me Zotërim Publik SOC (state owned enterprise/corporates). Ky sektor ka rëndësi të veçantë pasi menaxhon asete shtetërore dhe burime njerëzore. Po njësoj disa nga Kompanitë e këtij sektori ofrojnë shërbime ekskluzive për qytetarët (ujë, energji) apo veprojnë në sektor me rëndësi sa i përket sigurisë kombëtare (furnizimi me ujë, portet etj). Organizata jonë sikurse edhe aktorë të tjerë, prej vitesh e ka konsideruar këtë sektor me rrisht sa i përket menaxhimit, kontrollit financiar dhe përdorimit të asetëve dhe burimeve publike. Po njësoj keqpërdorimi i asetëve dhe burimeve publike në fushata zgjedhore është evidentuar sistematikisht në sektorin e SOC.

Sa më lart do dëshironim që një nga Objektivat Specifik të Strategjisë ti përkushtohet edhe rishikimit të Legjislacionit dhe Statuteve (përmes zotëruesve Ministri apo Njësi të Qeverisjes Vendore), duke garantuar Rregullim Ligjor, Nënligjor dhe Statutore të Shoqërive SOC-eve, të tillë që garanton menaxhim me meritokraci (kritere dhe konkurrim), rregulla të qarta për de politizim

të drejtuesve dhe menaxherëve të lartë, parashikime të qarta statutore për auditimet e brendshme, auditim të jashtëm dhe kontrollin financiar.

Rekomandime të qarta për këtë sektor janë dhënë edhe në Dokumentin me titull Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit: Shqipëri 2023, NIS përgatitur nga IDM si pjesë e Projektit të Transparency International EU4 Rule of Law: Citizen Engagement for Public Integrity (CEPI) in Eastern Balkanas and Turkey” Link file:///C:/Users/arani/Downloads/National-Integrity-System-Assessment-Albania-2023-ALB-WEB%20(4).pdf

Spektori SOC është i rëndësishëm sa i përket edhe plotësimit të kriterëve dhe kushteve të vendit si vend Kandidat për anëtarësim në EU, konkretisht kriterëve për Kontrollin Financiar (kapitull 32).

2. Përfshirja e Shoqërisë Civile, Organiata. Objektiv 3.3.2

Duke e konsideruar këtë aspekt si mjaft të rëndësishëm sa i përket Politikave Antikorrupsion do të sugjeroja targetim të më shumë rezultateve duke mos u mjaftuar vetëm me fushata ndërgjegjësuese. Parimisht do të sugjeroja aplikimin e marrëveshje bashkëpunimi të Ministrisë me Organizata të Shoqërisë Civile që punojnë në mbikëqyrje, denoncim dhe forcim të eficensës së ligjit në sektorët e përzgjedhur si sektor me rrisht. Këto marrëveshje do të garantonin edhe shkëmbim të evidencave, raporteve, produkteve të këtyre aktorëve civil (shoqata jo qeveritare, shoqata biznesi apo grupe interesi). Po njësoj evente të përbashkëta për ndërgjegjësim, edukim, rritje kapacitetesh për mirëqeverisje. Marrëveshjet e Institucioneve me OJQ apo Paktet e Integritetit (kryesisht sektori prokurim publik) janë mekanizma që janë aplikuar me sukses në përmirësimin e situatave Antikorrupsion në disa vende EU apo kandidate. Këto lloj marrëveshjesh do të lehtësonin punën e aktorëve watchdog dhe do të garantonin adresim më të saktë të gjetjeve mbi vlerësimin e rrisht që bën shoqëria civile.

Po njësoj do të sugjeroja që ky Objektiv përveç Fushatave Ndërgjegjësuese të konsideronte si rezultat edhe bashkëpunime të institucioneve me aktorët civil në dedektim dhe parandalim të rasteve korruptive.

Duke ju përgëzuar edhe një herë për dokumentin Draft Strategji, ne shpresojmë që propozimet më lart të konsiderohen për përfshirje sikurse ju urojmë suksese në finalizim dhe zbatim të kësaj Strategjie.

Me respekt

Aranita BRAHAJ – Drejtore Ekzekutive AIS

Tel 00 355(0)682001718

Email: aranita.brahaj@ais.al